



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 22114 Prot

Tiranë, më 3... / 9 / 2019

URDHËR

“Për testimin dhe liçensimin e agjentëve doganor”

Në zbatim të neneve 24 – 26 të Ligjit nr. 102/2014, date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; neneve 78 - 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" si dhe Udhëzimin Nr.5, datë 28.03.2019, "Për Zbatimin Praktik të Procedurave për Miratimin dhe Funksonimin e Përfaqësimit në Doganë", kreu VII, urdhëroj sa më poshtë;

Ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe marrjen në provim të agjentëve doganor të përbërë si më poshtë;

1. Arlind Gjokuta - Drejtor i Përgjithshëm i Doganave (Kryetar)
2. Saimir Sinani - Drejtori i Procedurave Doganore (Anëtar)
3. Skerdi Ramaj - Kryetar i Degës Doganore Tiranë (Anëtar)
4. Rubin Shehu - Kryetar i Degës Doganore Durrës (Anëtar)

- Testimi për agjentë doganor do të organizohet në datën 03 Tetor 2019 në ambientet e Degës Doganore Tiranë, Terminali doganor Vorë, në orën 10⁰⁰.

- Testimi do të jetë me shkrim dhe në mënyrë elektronike, do të përmbajë pyetje mbi njohuritë e përgjithëshme dhe zbatimin praktik të Kodit Doganor dhe Dispozitave Zbatuese. Minimumi i pikëve për të fituar testimin do të jetë mbi 70 pikë.

- Pas testimit do të mbahet një proces verbal mbi organizimin e testimit dhe me rezultatet e testeve nga Komisioni i Testimit.

- Ngarkohet Sektori i Procedurave që në bashkëpunim me Komisionin e Testimit të grumbullojë dhe administrojë materialet përkatëse të testimit dhe pas liçensimit ti dërgojë ato në arshivë.

- Ngarkohet Drejtoria e Mardhënieve me Jashtë dhe me Publikun për të bërë njoftimin përkatës në web-in e doganës dhe në mediat kryesore për këtë qëllim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

